# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474269**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kafshët te Kopshti Zoologjik po vdesin për ushqim, drerët hanë letrat e vizitorëve |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394515.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 16:13:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 16:09:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 16:08:00 UTC → 27 shtator 2026, 16:10:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `34e03975c88547f7a4cb3e8eb6548cf5c951dc4530076de681965d86393fc4d1` |
| TEKSTI | `53cdc1659c5db351b158933bcbc5a2a3a26827422402c768cdf4805a839b57a1` |
| PAMJA | `2a7196e4a3b65fae4890df0fb40c0c18baea83135f9f788edd196911d67e7725` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c00367a17b70ddd7581ea3cd861d00451147a760c091960a2d44e572426c53f3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c00367a17b70ddd7581ea3cd861d00451147a760c091960a2d44e572426c53f3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kafshët te Kopshti Zoologjik po vdesin për ushqim, drerët hanë letrat e vizitorëve

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 27.09.2026, 18:09





Një tjetër rast shqetësues është konstatuar në Kopshtin Zoologjik të Tiranës, ku drerët po përballen me mungesë ushqimi.

Në pamjet e siguruara nga JOQ ALBANIA, drerët afrohen te vizitorët dhe konsumojnë letrat që u jepen prej tyre. Edhe pse vizitorët paguajnë për të parë kafshët, atyre tani u duhet të marrin përsipër edhe ushqimin, qoftë ky i duhuri apo thjesht mjetet rrethanore që kanë aty pranë.

Vizitorët thonë se kafshët ndodhen në gjendje të rënduar, të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe të paushyqera siç duhet.

Ata shprehen se situata tregon për nevojën e një kujdesi më të madh dhe furnizimi të rregullt me ushqim për kafshët pasi kujdesi ndaj tyre duhet të jetë i vazhdueshëm, me ushqim dhe ujë të mjaftueshëm, ambiente të përshtatshme dhe kontrolle të rregullta veterinare.

Pamjet nga Kopshti Zoologjik ngrenë pikëpyetje mbi mënyrën se si po menaxhohen këto nevoja dhe mbi kushtet në të cilat mbahen kafshët.

Kafshët nuk mund të kërkojnë vetë ndihmë apo të largohen nga ambientet ku mbahen. Për këtë arsye, përgjegjësia për mirëqenien e tyre bie tërësisht mbi strukturat që kujdesen për to.

Situata kërkon vëmendje dhe verifikim nga institucionet përgjegjëse pasi nuk është çudi apo e pamundur që një ditë të bukur këto kafshë të ngordhin dhe fëmijët mos të kenë çfarë më të shohin apo kalojnë kohën e lirë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike
ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.